

AKT – THEMELIMI

I

SHOQËRISË “SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT – FAF Sh.a”.

Tiranë, 2008

1

AKT- THEMELIMI

PER

KRIJIMIN E SHOQËRISË “SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT – FAF Sh.a”.

Sot më datën 24.11.2008, Pronar i aksioneve të shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF Sh.a”, Shteti Shqiptar i përfaqësuar nga Ministri i Financave Z. Ridvan BODE,
Ne vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, date 27.06.2008, Aksioneri ka rënë dakort të hartojë këtë Akt- Themelimi për krijimin e shoqërisë tregtare “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF Sh.a.”

Neni 1

Mbi bazën e pushteteve (tagrave) të dhëna nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 27.06.2008, krijohet shoqëria tregtare “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF” e formes “Shoqëri Aksionare (SH.A)”

Emri i Shoqërisë është “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF” Sh.a.

Neni 2

Selia e shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF” Sh.a është në adresën “Rruga Dervish Hima Nr.4 Tiranë/Shqipëri”.

Neni 3

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj sipas ligjeve në fuqi dhe Statutit për një periudhë kohe të pakufizuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF Sh.a.” është ofrimi i shërbimeve financiare që përmbledhen si vijon:

- Të gjitha format e kredi-dhënies duke përfshirë të gjithë llojet e kredisë hipotekare e konsumatore;
- Faktoringu dhe financimi i transaksioneve tregtare;
- Të gjitha tipet e qirasë financiare;

2

- Shërbime të pagesave, dhe të transferimit të parave;
- Ofrimin e garancive, ndërmarrjen e angazhimeve;
- Këmbimi valutor;
- Tregtime të letrave me vlerë të transferueshme/negocijueshme për llogari të vet dhe/ose të klienteve;
- Shërbime ndihmëse, këshillimi, formimi dhe ndërmjetësimi për të gjitha veprimtaritë e mesipërme;
- Shërbime votësigurimi dhe shërbime sigurimi duke vepruar si agjent i kompanive të sigurimit;
- Shërbime të tjera financiare të lejueshme aktualisht dhe/ose në të ardhmen me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e autoritetit license-dhënës.

Neni 5

Kapitali i nënshkruar dhe plotësisht i paguar i Shoqërisë është 1,030,100,000 (një miliard e tridhjetë milion e njëqind mijë) lekë.

Kapital në natyrë 1,030,100,000 (një miliard e tridhjetë milion e njëqind mijë)

Kapitali ndahet në 10,301 (dhjetë mijë e treqind e një) aksione të zakonshme me një prejje për vlerë nominale 100,000 (njëqind mijë) L.ekë/për aksion:

Numërimi i aksioneve fillon nga numëri 1 (një) deri në numërin 10,301 (dhjetë mijë e treqind e një), përfshirë edhe numërin e aksionit të fundit. Cdo aksion është i pandashëm dhe siguron të drejtën e një vote.

Neni 6

Pronar i aksioneve të Shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF” Sh.a është Shteti Shqiptar i përfaqësuar nga Ministri i Financave.

Shtjta dhe transferimi i aksioneve të zotëruara nga Shteti Shqiptar i përfaqësuar nga Ministri i Financave do të kryhet vetëm ndaj *investitorëve strategjikë*, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Këshilli Mbikqyrës
- Administratori

Anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyrës janë: Z. Sherefodin Shehu – Kryetar; Zv/ Ministër i Financave; Z. Artur Pilkat – Anëtar; Përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës; Z. Shkelzen Marku – Anëtar; Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore; Z. Rezar Veseli – Anëtar; Përfaqësues i Këshillit të Ministrave, Departamenti Juridik; Z. Hysen Osmanaj – Anëtar; Përfaqësues i Ministrisë së Brendshme; Z. Myslym Osmani – Anëtar; Përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; të emëruar me Statut.

3

Administratori i Shoqërisë është Z. Bajram Korsita – i emëruar me Statut.
Eksperti Kontabël i Autorizuar është Znj. Leze Abazi – i emëruar me Statut.
Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre përcaktohen në Statutin e Shoqërisë.

Neni 8

Shoqëria e fillon veprimtarinë e saj pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë.

Neni 9

Dispozita të hollësishme, që lidhen me mbarrëvajtjen e shoqërisë në tërësi përcaktohen në Statutin e saj.

Neni 10

Ky Akt – Themelues për krijimin e shoqërisë tregtare “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF” Sh.a, mbahet në katër kopje origjinale.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan BODE



4